

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 22 SHTATOR 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurisht, jemi të detyruar të mos jemi 100% korrektë me këtë temë të rendit të ditës, për një arsye themelore. Në radhë të parë, e gjithë seanca e sotme ka prodhuar vetëm një ligj, ndërkohë që nisma ligjore shumë të rëndësishme dhe me shumë vlerë janë aty, flenë, bllokohen, nuk zhvillohen dhe, qëllimisht dhe detyrimisht, parlamenti degradon në këtë mënyrë. Megjithatë, sot jemi këtu në një moment shumë të vështirë, shumë delikat, kritik, i cili është i lidhur pikërisht me mëmën e të gjithë të këqijave, me korrupsionin, që ka tundur dhe ka rrëzuar përtokë të gjitha siguritë në këtë vend, duke filluar nga siguria kombëtare, siguria individuale, siguria ekonomike, siguria juridike, përfshirë edhe sigurinë shëndetësore.

Ngjarjet e fundit, të cilat bëhen tashmë publike, lidhur me rrëzimin e të gjitha sistemeve në shtetin shqiptar, njëri pas tjetrit, tregojnë qartazi që siguria kombëtare është tronditur thellë dhe njëherazi është shoqëruar nga papërgjegjshmëria e plotë e fshehjes së të vërtetës, qëllimet e të cilës i takojnë drejtësisë, që këtu duhet të ishte në vijën e parë dhe për të cilën bërtitet dhe duartrokitet kaq fort. Unë kam dëgjuar këtu shumë histori të solidaritetit të domosdoshëm që kërkohet të japë opozita për këtë çështje. Unë do të ndaloj edhe te përgjegjësia e qeverisë, sepse, njëherazi, pati ftesa për të qenë koherente, nga këta që rrinë këtej pas. Shumë mirë! Ky është një sugjerim shumë i mirë.

Të jemi koherente, por, në radhë të parë, koherente duhet të jenë ata që kanë në dorë qeverisjen e vendit, ata që duhet të japin garanci të sigurt. Çfarë garancish dha kjo qeveri, në mbledhjet e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, të shkurtit të këtij viti, 7 muaj më parë, kur garantoj se sistemi ishte solid dhe nuk kishte asnjë problem, ndërkohë, siç rezulton nga raportet zyrtare, sistemi kishte rreth 8 muaj që hakerohej sistematikisht? Edhe në një mbledhje të dytë të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, institucionit më të lartë të sigurisë në vend, u dhanë garanci të

tilla. Cila është e vërteta? Gënjen? Janë të pazotë? Nuk e njohin sistemin? Nuk kuptojnë se ç' ndodh në vend, kur 8 muaj po hakerohej?

Këtë përgjigje duhet të japin këta! Për çfarë do të gënjejnë? Ku ka vend për propagandë këtu? U është kërkuar të verifikohet dhe kanë thënë: “Jemi shumë në rregull”. Janë shumë në rregull dhe verifikojnë që “marrin ujë” nga të gjitha anët, që nuk dinë ku e kanë kokën. Në rast se garancitë jepen në mënyrë të përsëritur, atëherë do të thotë që ka pasur interes që kjo portë të rrijë e hapur, sepse çdo person i përgjegjshëm në këtë sallë këtë do të ngrinte në këtë moment: i gjithë ky mekanizëm i domosdoshëm të ngrihet në këmbë për verifikim, me ndihmën e partnerëve e të tjera. Kjo nuk ndodhi. Po më pas, çfarë ndodhi? Ditë më parë, rreth 1 muaj e ca më parë, Kryeministri i vendit, jo unë, del dhe thotë: “Kundërofensiva është e suksesshme, agresori është në tërheqje”.

Kush ka nevojë për këto idiotësira metaforike, figura artistike? Këtu bëhet fjalë nëse sistemi kontrollohet ose jo. Në kuptimin më të plotë të fjalës, këto janë idiotësira kriminale, nuk janë thjesht idiotësira. Së dyti, çfarë na tha? Madje, citimin e kam marrë nga “Zëri i Amerikës”, ku po ky individ thotë: “Agresioni nuk ia ka arritur fare qëllimit, asnjë zhdukje, asnjë rrjedhje serioze të dhënash”. Janë këta që flasin për koherencë! Ky i ka deklaruar, nuk i kam deklaruar unë. Po çfarë ndodh pas deklaratave të tij? Lidhur me të dhënat, që janë kaq të rënda dhe kaq problematike (nuk janë prononcimet e mia këto, po mbështetem vetëm në prononcimet e qeverisë dhe të institucioneve), në momentin që vendos ndalimin, prokuroria thotë: “Publikimi i këtyre të dhënave cenon rendin publik dhe sigurinë kombëtare”.

Janë të dhëna sensitive këto, janë të dhëna serioze. Nëse dëgjojmë Kryeministrin themi: “i lumi unë, s’na ka ndodhur gjë!”. Prokuroria thotë që këto të dhëna cenojnë sigurinë kombëtare. Pra, në dorë të kujt është shteti? Kjo është pyetje e madhe. Thjesht të papërgjegjshëm pas afro 10 vjet pushtet! Një raport tjetër i përbashkët i FBI-së amerikane me Microsoft-in jep një të dhënë tjetër, ku thuhet: “Sistemi, që 3 vjet më parë, duhet të kishte bërë, atë që quhet, përditësimin e tij, rifreskimin e tij, për të qenë i mbrojtur dhe kjo portë e pabërë nga qeveria është përdorur për të hakëruar të dhënat”. Kush e mban përgjegjësinë për këtë, për integritetin e sistemit? Kush do t’i bëjë update-et, opozita, pavarësisht nga dëshira e madhe për të bashkëpunuar?

Kush do t'i bëjë? Kjo është pyetja. Është bërë në mënyrë të papërgjegjshme? Kaq nuk kuptojnë? Kaq nuk dinë? Në qoftë se do të marrim variantin më pozitiv, më të mirin e varianteve, që nuk kuptojnë dhe nuk dinë, pse vazhdojnë të qeverisin akoma? Kujt i duhen këta sharlatanë që vazhdojnë e qeverisin, që "marrin ujë" me vite deri sa të gjitha sistemet bien, njëri pas tjetrit, të gjitha pa përjashtim? Ka mundësi që, kur të vijmë në seancën e radhës, të enjten ose të hënën, të thotë: "Ne e mundëm, agresioni shkoi andej mbrapa, ne i dolëm në krahun tjetër dhe e mposhtëm". Ja, këto janë të dhënat! Ky është fakt! Pra, siguria kombëtare është, absolutisht, në një gjendje më të tronditur se kurrë. Për kuriozitet, ne pamë njoftime edhe në media, ku vetë agjencia, AKSHI, kishte nxjerrë shpallje, në të cilat kërkonte të punësonte dhjetëra njerëz në profilin informatist.

Tani u kujtuan të marrin informatistë? Informaticientët duhen kur ngrihet sistemi, kur ofrohen të gjitha siguritë dhe kur qytetarëve u thuhet: "Përfundimisht, ky është sistemi me të cilin do të punojmë, i sigurt, i mbrojtur dhe do t'i drejtohem kësaj forme të re, jo më asaj të vjetrës, dhe për këtë kemi garanci". Po cilat janë garancitë? Të gjitha të dhënat e të gjithë personave që janë në këtë sallë, janë në dorë të "drejtit dhe të të birit" dhe mund t'i përdorin si të duan. Sigurisht, preludi ishte që kur dolën të dhënat përpara zgjedhjeve dhe patronazhistët u rrëmbyen prej qafe, u tha: "Këta janë trimat, djemtë, vajzat, gratë dhe burrat e mirë", sepse këta kanë marrë këto miliona të dhëna, por tani ato të dhëna, që ishin me miliona, hapën dyert për miliona të tjera dhe praktikisht e zhveshën komplet çdo element të sigurisë kombëtare, por edhe të sigurisë individuale, sepse siguria e gjithsecilit është vënë në rrezik.

Sigurisht, e njëjta gjë vlen për të gjitha siguritë e tjera, përfshirë këtu edhe një siguri të madhe, atë që quhet siguria ekonomike, e tronditur si kurrë më parë, përballë furtunës së çmimeve, pa asnjë gram mbrojtjeje, pa lëvizur asnjë taksë, pa marrë as më të voglën masë ekonomike dhe duke shpikur "bordin e kusarëve", me të cilin qesh e gjithë dynjaja. Përfundimisht, cila është analiza? Qytetarët e kësaj qeverie, që ka marrë përsipër t'u dalë për zot, do të ishin shumë të lumtur të jetonin në Maqedoninë e Veriut, në Kosovë, apo në Mal të Zi, sepse nuk do të paguanin çmime çnjerëzore. Nuk dimë çfarë t'u themi. Cilat janë detet që lagin Maqedoninë e Veriut, cilat janë rrugët ndërkombëtare që fillojnë në Maqedoninë e Veriut, cilat janë këto

aksese minerale, energjetike që ka Maqedonia e Veriut, që i trajton qytetarët e vet në këtë mënyrë?

Po jua them përsëri, diferenca është se kanë një qeveri të përgjegjshme, nuk kanë një qeveri hajdutësh. Zgjidhja është kaq e thjeshtë! E fundit është ajo që dërmon të gjitha siguritë e tjera, siguria juridike. Çdo element juridik, çdo akt juridik, për shkak të kësaj qeverie, është bërë i pavlefshëm, i tronditur dhe të gjitha hierarkitë juridike janë përmbysur, duke arritur deri në banalitetet që kemi parë ditët e fundit, ku për të njëjtin fenomen, këtu duhet t'u vijë turp të gjithëve, në mënyrë të veçantë atyre që kanë "zanatin" e juristit, dikujt i vihet ruspa, tjetrit i bëhet gati amnistia. Njërit, që ndërron pllakat e WC-së, i shkon Policia Bashkiake, ndërkohë kullat ngrihen në mënyrë të padukshme brenda natës. Këto turpe kanë vetëm një përgjigje, janë fundi i një qeverie që, thjesht dhe vetëm, ka agoni, por sëmundja është pa shërim. Faleminderit!